



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 073/25 Dt. 31.01.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008”), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal në Zonën Ekonomike “Jug” të datës 16 dhjetor 2008, të vendimit datë 24.01.2018 të Kuvendit të AZHR Jug, Termave të Referencës për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit Rajonal për Projekte Komunale (ERPK) Nr.27022020ERPK, Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug” (AZhR Jug) 01/nr. 021/25 datë 21.01.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të granteve direkte dhe shpenzimeve administrative për Agjencinë për Zhvillim Rajonal Jug, për vitin 2025, në shumën prej 72.500.00 € (shtatëdhjetë e dymijë e pesëqind euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug” (AZhR Jug) 01/nr. 021/25 datë 21.01.2025.
3. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij vendimi, do të alokohen (bëhet pagesa) në llogarinë bankare të AZHR Jug.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - AZHR Jug,
 - Arkivës së Kryetarit.

